

PROCESVERBAL-Tipi I kontratës-PUNË
PËRARGUMENTIMINDHEMIRATIMIN ESPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTIIPROKURIMIT:

“Ndertim Ujesjellesi Rajonal Trebinje , burimet e Kozices , Bashkia Pogradec

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):

45247130-0 Punime ndërtimi për ujësjellës.

VLERAEFONDITLIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **451 397 182.5** (katerqind e pesedhjet e nje milion e treqind e nentedhjet e shtate mije e njeqind e tetedhjet e dy pike pese) lekë pa TVSHi **ndare ne vitet financiare**

Viti 2024: 90 327 778,34 (nentedhjet milion e treqind e njezet e shtate mije e shtateqind shtatedhjet e tete pike tridhjet e kater) leke pa Tvsh

Viti 2025: 135 491 666,67 (njeqind e tridhjet e pese milion e katerqind e nentedhjet e nje mije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte pike gjashtedhjet e shtate) leke pa Tvsh

Viti 2026:135 491 666,67 (njeqind e tridhjet e pese milion e katerqind e nentedhjet e nje mije e gjashteqind e gjashtedhjet e gjashte pike gjashtedhjet e shtate) leke pa Tvsh

Viti 2027: 90 086 070,82 (nentedhjet milion e tetedhjet e gjashte mije e shtatedhjet pike tetdhjet e dy) leke pa Tvsh

Argumentimi I Autoritetit Kontraktor

Në lidhje me përcaktimet në VKM Nr.285/2021 per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 45 ku kërkohet“Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos,autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë,si dhe peshën specifike për secilin kriter,konkretisht,pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e një pasnjëshëm.,vlerësojmë s imëposhtë:

Së pari në DST **Kapitulli 4.4**“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më efavorshme,bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët50

Grafiku I punimeve dhe koha e mobilizimit _ _	pikët20
Stafi/Organizimi I Kompanise _ _	pikët15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social _ _	pikët10
Periudha e garancisë së objektit _ _	pikët5

Kjo kërkesë është bërë në zbatim të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”,të ndryshuar,neni 87“ Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”ku përcaktohet:

1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2.Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos,duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, nëpërputhje me nenin 88 të këtij ligji,**dhe mund të bazohet në raportin më të mire çmim-cilësi**,që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë,**duke përfshirë cilësinë,aspektet mjedisore dhe/ose sociale.**

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) **cilësinë**, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) **organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit** që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, përshembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm përkriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit *shkallën e rëndësisë relative që I jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme*, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Autoriteti Kontraktor shpalli kërkesën për Grafikon e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar përkëtë kriter **20 pikë**, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin me sukses të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precision në kryerjen e punimeve, por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë, ndihmësetj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor **por dhe njëherësh me cilësinë e duhur**, duke I dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të plotë të operatorit ekonomik pjesëmarrës I cili në përfundim do të sjellë rezultate të kërkuara dhe të pritura nga ky autoritet.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rënësi e vecantë nga autoriteti kontraktor I jepet edhe elementit **Stafi/Organizimi i Kompanisë, I cili vlerësohet deri në 15 pikë**, duke ditur që vetëm një staf I kualifikuar profesional inxhiniero-teknik dhe me përvojën e duhur mund të sjellë rezultate të dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik I cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projek preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me **përvojë/experience** të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nën kriteret janë **formimi akademik I stafit kyç** dhe eksperiencia në fushën specifike i cili provohet me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe **skemën e organizimit të stafit** të propozuar për realizimin e kontratës, organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet përuljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojmë në mjedis dhe në komunitetin tone të përbashkët pozitivisht/negativisht.

Duke patur parasysh se përveç realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe **parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi I ndikimeve negative ndaj mjedisit.**

Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një vepre mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm I gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja apastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi I të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, florëdhefaunë, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj.

Në veçanti duhet t'i kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi I procedurave, normave, standarteve dhe planifikime te paraqitura ne project gjate realizimit te tij si dhe **të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.**

Për të gjitha këto element operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe te detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë **Propozime konkrete** sesi do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nënkriteret për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar ng aKomisioni Vlerësimit të Ofertave I Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

1. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësorememjedisin)/të ricikluara /efiçente/ material që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike. Hartimi I një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.
2. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë locale të zones ku zhvillohet projecti si një initiative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.

Një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe **Periudhës së garancisë së objektit** e cila tregon jetëgjatësinë e objektit, faktin se sa më maksimale të jetë **periudha që përfshin garancinë e veprës,** e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final **realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.**

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78,pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoritetit Kontraktor,ka hartuar procesverbalin për rargumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedure e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2.KRITERET E VEÇANTATË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesiduhettëparaqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit,sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimine Ofertës,sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesiduhettëparaqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes /Kualifikimit pika 1e Shtojcës 7

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme bazohet në kerkesat e pikës 1,Shtojca7.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1Kopje te certifikuara te bilanceve te tre viteve te fundit 2021, 2022, 2023 te konfirmuara me vule prane administrates tatimore. Operatoret Ekonomike te cilet plotesojne 2 nga 3 kerkesat e germes “c” te nenit 41 te Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të

regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” te ndryshuar; krahas bilanceve te paraqesin dhe raportet e audituesit te pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) per bilancet e ketyre viteve te konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera **451 397 182.5** (katerqind e pesedhjet e nje milion e treqind e nentedhjet e shtate mije e njeqind e tetedhjet e dy pike pese) lekë pa TVSH e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do te konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën njëvit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorë ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomikë edhe financiare**;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomikë financiare” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, paragrafi 1 dhe 2 gërma “b”, parashikohet: Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vite te fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore qëu kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **b) vlerën e perlllogaritur te kontrates ose lotit ne procedurat e prokurimit ndermjet kufirit te larte dhe te ulet monetar**

Nëse vlerësohet, autoriteti/entikontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite te fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Përcaktimi I vite vetë kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, neni 29 I tij I cili përcakton: “Çdo tatim pagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda dates 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekse te tij, s idhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, Pika 3.12 etij, sidhe kërkesat e të Ligjit Nr.25 date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe

përfundon në datën 31dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligji Nr.10091 datë 05.03.2009 “Përauditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm në përmjet forms elektronike”. Në këto kushte, vlerësojmë të kërkojmë këtë dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekse të tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushte të parashikuara nga ligji.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriterë janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi të përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
- Fatura tatimore perkatese te deklaruar ne organet tatimore.

Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma "b" duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatoreve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" ku përcaktohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një Nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**"

Në nenin 39 "Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike" pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi I njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/entikontraktor, sidëshmi për përvojën mëparshme, kërkon vërtetimet e lëshuar nga një ent publik, përpërmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, përtë vërtetuar përpërmbushjen e suksesit të punëve. Në rastin e përvojës mëparshme të realizuar në sektorin privat, autoriteti/entikontraktor kërkon sidëshmi, vërtetime, përpërmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat vlerëson të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës."**

Autoriteti Kontraktor përcakto ikriteret për punë të ngjashme si më lar tduke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhurame objektin e kontratës. Përvoja te mëparshme janë element shumë i nevojshëm, që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën mesukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriterii kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Pjesë marrja e operatorëve ekonomikë më përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e më parshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët të jenë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situata të mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedurë.

Referuar këtij neni, AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit" (I ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që prokurorët është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punime të mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zëra të punimeve që po prokurorët, si dhe në rastin kur punime të më parshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e antarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoriteti kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqenëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), A Kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin ekzyerjes së punëve të ngjashme.

Ndërsa me ndryshime të reja ligjore përkatësisht me VKM Nr. 498, datë 01.8.2024 për disa shtesat e ndryshimeve në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 16 ku parashikohet "Në paragrafin e fundit, të pikes 5, të nenit 39, "Kërkesatë veçantë për kontratat për punë publike", pas fjalëve "...e shoqëruar me fatura tatimore..." shtohen "...të deklaruara në organet tatimore..." u kërkuar që në kërkesën e bërë për punime të ngjashme të kryera dhe të realizuara me sektorin privat: si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, të paraqiten vërtetimet e shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore kutë shënohendat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacionet përfundimtare për të vërtetuar përmbushjen e suksesit të punëve.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Argumentimi:Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe eparaqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve ekonomikë e shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve,ku të cilësohen punimet që kamarrë përsiper të kryejë secili anëtar BOE,sipas parashikimeve të nenit 88 tëVKMNr.

285datë19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,të ndryshuar.Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktorka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t,mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 2Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **Kategoria NP- 1** Punime germimi në toke **Klasifikimi D**
- **Kategoria NP- 2** Ndërtime civile dhe industriale **Klasifikimi F**
- **Kategoria NP- 4** Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai.....**Klasifikimi C**
- **Kategoria NP- 7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi evaditje **Klasifikimi F**
- **Kategoria NP-11** Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve linja **Klasifikimi A**
e TN e të mesem dhe shperdarjen e energjise)
- **Kategoria NP-12** Punime të inxhinierise se mjedisit**Klasifikimi A**
- **Kategoria NS -1** Punime për prishjen e ndërtimeve **Klasifikimi B**
- **Kategori NS – 5** Impinate të sinjalistikes ndriçuyese të trafikut **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 6**Sinjalistika rrugore jo ndriçuese **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS – 9** Punime strukturore speciale **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-13** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni**Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s' kualifikues.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77pika1/adhe2tëligjitNr.162/2020“Për ProkuriminPublik¹”te ndryshuar,në të cilët përcaktohet:“Autoritetet ose entetkontraktorepërcaktojnë kërkesatpërkualifikimpëroperatorëtekonomikëbazuar në:afhtësinëteknikedheprofesionale;...Për sai përketpërshtatshmërisëpërtëkryernjëveprimtariprofesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me afhtësitë teknike dhe profesionale,autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore teknike,sidhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi tëpërështatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/entikontraktorkërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë së rrealizimit të punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 e ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedura të dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zëravetë punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), sidhenë zbatim të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, AK vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licencën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivele të kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe nivelit të klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmeve) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respective dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për kë të objekt.

Niveli i klasifikimit për kategoritë respective është kërkuar duke u bazuar në zëra të punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Kategoria N.P-1 “Punime gërmiminë tokë” Konsiderohen gërmimet, sistemet dhe ndryshimet në vullmet tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që dot të gërmohet ose sistemet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh punimet për këtë kategori si: gërmime dhe umjetet eskavator me goma, me zinxhretj, që dot të kryhen me qëllim ndërtimit e veprës. Këto procese janë parashikuarnë preventiv dhe specifike teknike të publikuarnë Sisteme Prokurimit Elektronik.

Kategoria D i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NP2

Kategoria N.P. 4 “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale”

Konsiderohen punimet për Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës

hekurudhore.

Kategoria C i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Kategoria N.P-7 “Ujës-jellës, gazsjellës, vajsjellës, veprakullimi evaditje”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime mendërhyrjenë rrjetqëjanëtënevojshme për realizimin “es herbimithidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse dhe në pikat e veçanta si edhe të gjitha impiantet mekanikë të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhimit të ujërave, impiantet e trajtimit të ujërave të pishëm, ujës-jellsat, kullat e ujërave, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngjitura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesit, furnizimin dhe vendosjen e veprave të tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, sidhetrajtimit të ujërave të përdorura.

Kategoria F i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Kjo kategorilicence referohet **objektit të kontratës dhe punimeve kryesore** që parashikohen në preventiv për realizimin e veprës.

N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji të tensionit, furnizimin dhe vendosjen në veprë të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimi të kompaktësimi të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimi natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpave rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Kategoria C i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S –1 Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut

Konsiderohet vendosja në veprë, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-6 : Sinjalistika rrugore jodriçuese

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jodriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S- 9 Punime strukturore speciale. Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampionëve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidim të terreneve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.S - 18 Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. *N.S - 19* Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

a) Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme si më poshtë:

- *EN-ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)ose ekuivalent*
- *EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)ose ekuivalent*
- *EN-ISO 45001:2023 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)ose ekuivalent*
- *ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut)ose ekuivalent*

Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nese certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të perkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Certifikatat duhet të jene të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit Nese ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat duhet të jene në përputhje me punimet e marra persiper.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet:*

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues,

të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

a) **Ne perputhje me kërkesat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe preventiv, per listen e artikujve, si me poshte:**

- **Materiale hidraulike dhe rakorderi Tuba PE**
- **Tuba te brinjezuar HDPE SN8**
- **Mates uji**

Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

1. Autorizim te Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesitose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nenshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe.
2. Katalogun / et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit / ve per listen e mesiperme te artikujve ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Shenim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.
3. Të gjitha materialet e mesiperme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane. Per keto materiale Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetedeklarim qe deklarone se sistemi i menaxhimit te cilesise te prodhuesit / ve eshte sipas standartit ISO 9001-2015 ose ekuivalent dhe ISO 14001-2015 ose ekuivalent. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjate procesit te vleresimit të dokumentacionit.

Shenim: Te gjitha normat dhe standartet e kerkuara ne specifikimet teknike te publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve te tyre, standarteve shqiptare SSH te miratuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit DPS, ne ato raste kur keto standarte jane unifikuar nga kjo Drejtori.

Argumentimi: *Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga njësi e prokurimit, pasi në objektin e kësaj komiteti të bëmë materialet (artikuj) që dot të vendosen në veç të veç, bazuar në dispozitatë sipërcituar dhe referuar nën*

- *40 pika të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, kupërvërtetimin e përmbushjes së tyre duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogu tëse pjesët e tyre, me qëllim realizimin e sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementët më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve **Materiale hidraulike dhe rakorderi Tuba PE*****
- **Tuba te brinjezuar HDPE SN8**
- **Mates uji** *që dot të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.*

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriteri arsyesishëm dhe idomos dhe për të siguar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e bërjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik kamarrëleje zyrtare nga prodhuesi ose distributor për të ofruar mallrat e tyre në treg. Për meskëtë kriteri, Autoriteti mund të

sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimit të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Për mësinformacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti kontraktor ka mundësi të kontaktoj me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatorët ekonomikë. Kjo siguron se çdo detyrë që shprehim mund të shprehim mund të adresohet me lehtësi dhe përbashkë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesitose distributorit nënkupton që operatorët ekonomikë shtepërgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midistyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatorët ekonomikë shtepërgatitur për të bashkëpunuar me Prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Për mëskëti kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatorët ekonomikë ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre. Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogutose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriteri ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogutose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që dot të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhënat e detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti Kontraktor ka një pamjetë qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomikë shtënë gjendjet për mbushje specifike me teknike dhe standartet e kërkuara për mallrat e planifikuara. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshëm me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshëm për detyrën specifike

3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 170 (njqindeshatëdhjetë) punonjës për periudhë 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e

parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **170 (njqindeshatëdhjete) punonjes**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në baze të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve (Specialiste + punetore krahu, manovratore, kamioniste, etj.) duhet të jete mesatarisht të paktën **170 (njqindeshatëdhjete) punonjes**. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **170 (njqindeshatëdhjete) punonjes** persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nenligjore.

ARGUMENTIMI I NUMRIT TE PUNONJESVE

Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si mëposhte:

Total ore pune= 612000 ore

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 612000/8ore=76500 dite pune

Dite pune gjithesej= 18 muaj x25 dite/muaj=450 dite pune

Numri i fuqisë punëtore = 76500 dite/pune/450 dite=170 punetore

Ne menyre te permbledhur numri i fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshte minimumi 170 puntore

Operatori Ekonomik duhet te kete te punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **Drejtuesit Teknik drejtues teknikë licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Menaxhim projektesh 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Drejtuesit Teknik te jene te përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes se tenderit, te kene kontrate pune te vlefshme.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, per Drejtuesit Teknik duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohës se zbatimit te punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale
- CV
- Libreze pune

****Kriteri konsiderohet i përmbushur mevetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

c) Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Libreze pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) CV
- d) Diplome Universitare

Për stafin e mësipërm inxhinierik duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshmegjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Libreze pune dhe CV.

- Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohës se zbatimit te punimeve objekt kontrate;
- Diplomë profesionale;
- Curriculum Vitae
- Libreze pune;

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti*

kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika d, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

c) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik te perbere nga te pakten **35 (tridhjetë e pese)** punonjes te specializuar dhe te çertifikuar sipas profesionit qe kryejne dhe te pasqyruar ne liste pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, me profesione si me poshte:

- 3 (tre) hidraulike
- 2 (dy) teknik ndertimi
- 5 (pese) muratore
- 3 (tre) saldatore
- 4 (kater) specialiste elektricisteme minimumi kategorine e III-te te kualifikimit
- 4 (kater) specialiste karpentier
- 4 (kater) hekurkthyes
- 2 (dy) specialist hidroizolues
- 2 (dy) bojaxhi
- 1 (nje) betonues
- 1 (nje) montator per konstruksione metalike
- 5 (pese) shofere për drejtim mjeteshte pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (*me përjashtim tëpunonjësve shoferë*) të paraqitenkartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, tëlëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Shënim:Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

e) Operatori Ekonomik duhet te kete te pakten :

- **8 (tete) Manovratore / Eskavatoriste / Automakinist**

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinë*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të dryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, , inxhinierik lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinieret në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Operatori Ekonomik duhet te kete të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se eshte inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i certifikuar si "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 te VKM Nr.285 date 19.05.2021 secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" sipas zerave te punimeve / shërbimeve / mallit qe do te marre persiper te realizoje sipas akt marreveshjes / kontrates se bashkepunimit.
Ose
- -1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").
-1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
-Operatori Ekonomik duhet te kete te punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek te kontraktuar nga jashte me kontrate shërbimi / me subjekte te specializuara per kete qellim. Mjeket te jene te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

-si dhe mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këto qëllime. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë për të siguruar garancinë e ecurisë e punimeve

4.Operatori Ekonomik të disponojë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar dhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cilat përfshihen në nënkategorinë III.2. B të fushës III të vendimit Nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/ aponëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disarregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/ aponëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disarregullimet e tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria nënkategorisë III.2. B specifikohet në veprimtaritë të tillas grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.7 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	3 (tre) cope
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton	3 (tre) cope
3.	Kamionçina	4 (kater) cope
4.	Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa	3 (tre) cope
5.	Autovinç minimumi 5 ton	1 (nje) cope
6.	Rimorkiator për transportin e makinerive	1 (nje) cope
7.	Eskavator me zinxhir	3 (tre) cope
8.	Çekic Pneumatik	1 (nje) cope
9.	Minieskavator	3 (tre) copë
10.	Autobetoniere	1 (nje) cope
11.	Betoniere të vogla	3 (tre) cope
12.	Vibrator Betoni	1 (nje) cope
13.	Armature Kallëperi betoni	1000 m ²
14.	Makineri Prerese / Sharre Betoni / Asfalti	1 (nje) cope
15.	Asfaltshtruese	1 (një) copë
16.	Autobitumatrice	1 (një) copë
17.	Rul ngjeshës për asfaltim	1 (një) copë
18.	Autobetoniere	1 (një) copë
19.	Pompë betoni	1 (një) copë
20.	Autobot uji	1 (nje) cope
21.	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	2 (dy) cope
22.	Saldatrice	2 (dy) cope
23.	Pajisje për testimin e linjes së tubave	2 (dy) cope
24.	Matës largësie / Instrument për Topogjeodezim	1 (nje) cope
25.	Matrapik	4 (kater) cope
26.	Sistem Wellpoint	1 (nje) cope
27.	Motogjenerator	2 (dy) cope
28.	Total Station + GPS të kalibruar	1 (nje) cope
29.	Tok Mak Elektrik për ngjeshje dheu	1 (nje) cope
30.	Pajisje për skanim të infrastrukurës nëntokesore	1 (nje) cope
31.	Kulle ndricimi	1 (nje) set
32.	Aparaturë elektronike për kontrollin e presionit, Pompë presioni deri 60 bar për të realizuar procedurën e testeve të presionit.	1 (nje) cope
33.	Aparaturë elektronike për kontrollin e presionit, Pompë presioni deri 25 bar për të realizuar procedurën e testeve të presionit.	1 (nje) cope
34.	Makineri mikrotuneli për shpime horizontale me drejtim të kontrolluar (HDD) me diametër DN 160-250 mm	1 (nje) cope

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kerkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Per miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier", si më poshtë vijon:

- Kokore + Jeleke fosforeshente minimumi 100 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Per mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokument që verteton pronësinë e mjetit (çertifikate pronësie), dokument që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi); të vlefshme. Per mjetet e siguruar me qera, të paraqiten dokumentet që vertetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. Keto dokumente duhet të shoqerohen me kontratën përkatëse të qerave të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Per mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / fatura tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit.

Per pajisjet në pronësi shoqerohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit- blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) të vlefshme.

Per pajisjet me qera të paraqitet kontrata e qirase shoqeruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit- blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) të vlefshme.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Njesia e prokurimit